



Adres: Rr. Nëna Terezë Nr 35 10000 Prishtinë

Tel: +381 38 222 859, +377 44 165 040 Email: bspk@bspk.org

Në mbështetje të nenit 10, pika 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut, nr.2003/13, me ndryshimet dhe plotesimet e Rregullores së UNMIK-ut 2004/45, e duke e zatur Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-16-0268-A0001, dt. 24.08.2017, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK)

PUBLIKON

NJOFTIMIN për punëtorët e Ndërmarrjes Shoqërore (NSH) “Konfeksioni”-Rakosh, MIT141-Rashka, me qëllim të grumbullimit dhe dorëzimit të dokumentacionit të punëtorëve për këte NSH lidhur me hartimin e listës fillestare në formatin tabelar excel për përfitimin e një pjese prej 20% të të ardhurave nga privatizimi-likuidimi i NSH-se të theksuar më lartë nga kompetenca e BSPK-së dhe ate:

1. Libreza e punës (për punëtorët që i posedojnë),
2. Në rast të mungesës të Librezës së punës, çfarëdo dokumenti tjetër (kontrata apo vendime të punës) që dëshmojnë themelimin e marrëdhënies së punës, përkatësisht përfundimin e punësimit në NSH,
3. Vendimin eventual për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për periudhën 1989-1999, gjatë aplikimit të masave të dhunshme diskriminuese nga ish Kuvendi i Republikës së Serbisë (nëse posedojnë këte vendim),
4. Dokumentet në komunat përkatëse, Dep. për çështje sociale për të rënë në Luftën e Kosovës 1997-1999, qoftë luftetarë të lirisë, por edhe të viktimave civile,
5. Çfarëdo dokumentacioni tjetër i cili dëshmon dhe arsyeton pretendimin për të drejtën e punëtorëve për t’u përfshirë në Listën fillestare në formatin tabelar excel që do të hartohet nga menagjmenti dhe sindikata e NSH përkatëse në bashkëpunim me BSPK-në.
6. Ekstrakti i lindjes dhe kopjet e lejes së njoftimit,
7. Numrat e tel. kontaktues

Të gjitha dokumentet që do të dorëzohen duhet të jenë të noterizuara nga noteri kompetent.

Dokumentacioni dorëzohet në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, rr. “Qamil Hoxha” nr. 8, 10000 Prishtinë, personalisht dhe përmes postës.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të punëtorëve është 30 ditë nga publikimi i njoftimit në mjetet e shkruara të informimit publik.